



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:263464  
Datë: 24.03.2020  
Numri i dokumentit: 00901692

**A.nr.1011/17**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe me zyrtaren ligjore Asliha Fejzullahu, si procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditësit NNP “B...” SHPK me seli në Han të Elezit, kundër të paditurës Komuna e Hanit të Elezit, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulimin e aktit administrativ të paditurës nr.08-nr.2653/94-2017 i datës 23.05.2017 dhe të vendimit me 08/nr.4093-2017 i datës 19.03.2018, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur në prani të autorizuarit të paditësit av.S.K. dhe të autorizuarit të paditurës Bajrush Laçi, me datë 03.03.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET E BAZUAR** kërkesëpadia e paditësit NNP “B...” SHPK, me seli në Han të Elezit.
- II. **ANULOHET** vendimi 08/nr.4093-2017 i datës 19.03.2018 i Komunës së Hanit të Elezit, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Me aktin administrativ nr.08-nr.4093-2017 i datës 08.06.2017 të titulluar si përgjigje në ankesë e paditura Komuna e Hanit të Elezit-Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e lëshuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës të Hanit të Elezit 08-nr.2653/94-2017 të datës 23.05.2017, me të cilin paditësi ishte ngarkuar me pagesën e taksës vjetore, për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2017, në shumë prej 280.00€. Ndërsa me vendimin nr.4093-2017 të datës 19.03.2018 Komuna e Hanit të Elezit-Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka refuzuar ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, për caktimin e taksës vjetore komunale dhe ka shfuqizuar përgjigjen në ankesë me nr.4093-2017 të datës 08.06.2017.

Paditësi përmes të autorizuarit, me padinë e paraqitur në gjykatë, me datë 15.06.2017, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Komuna e Hanit të Elezit, për shkak se të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet padia e paditësit si e bazuar, të anulohen aktet administrative të paditurës Komuna e Hanit të Elezit me nr.08-nr.2653/94-2017 i datës 23.05.2017 dhe

08-nr.4093-2017 i datës 08.06.2017 si të kundërligjshme dhe paditësi të lirohet nga pagesa e ngarkesës-taksës në shumë prej 280.00€.

Më tej paditësi në padi dhe në seancën e shqyrtimit përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se e paditura duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit nga ana e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Ngarkesat Vjetore të ushtrimit të veprimtarisë afariste, e ka refuzuar ankesën e paditësit me aktin 08-nr.4093-2017 të datës 08.06.2017, duke mos dhënë asnjë arsytim të përcaktuar me nenin 85 dhe 86 të LPA-së, për ti arsyetuar pretendimet në ankesë, por akti përfundimtar i të paditurës është pa arsytim, pa të dhëna të qarta, është kontradiktor dhe rrjedhimisht i barasvlershëm me mungesën e arsytimit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor i autorizuari i paditësit ka deklaruar se meqenëse drejtpërsëdrejti i është dorëzuar vendimit i të paditurës me nr.08-nr.4093-2017 i cila a ka shfuqizuar përgjigjen në ankesë të paditurës me nr.4093-2017 të datës 08.06.2017 dhe e ka refuzuar ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik me të cilin paditësi i është caktuar obligimi për pagesën e taksës vjetore për vitin 2017, e precizoj kërkesëpadinë në paragrafin dy të petitumit ashtu që tani e tutje kërkoj nga gjykata anulimin e aktit administrativ të paditurës Komuna e Hanit të Elezit me nr.08-nr.265394/94-2017 i datës 23.05.2017 dhe vendimit me 08.nr.4093-2017 të datës 19.03.2017 dhe paditësi të lirohet nga obligimi në pagesën e ngarkesës në shumë prej 280€, në emër të taksës për ushtrimin e aktivitetit biznesor për vitin 2017. Ka shtuar se edhe ky vendim i të paditurës bazohet në të njëjtën bazë juridike si akti i mëparshëm (përgjigja në ankesë), përkatësisht rregulloren e brendshme të paditurës për pagesën e taksave, tarifave dhe ngarkesave administrative.

E paditura Komuna e Hanit të Elezit në përgjigjen në padi të datës 26.12.2019 ka deklaruar se e konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si jo përmbajtjesore dhe të pa bazuar në fakte dhe argumente. Ka theksuar se me Ligjin për Financat dhe Pushtetin Lokal të Republikës së Kosovës nr.03/L-049, dispozitat e nenit 10 paragrafi 10.2, komuna mund të përcaktoj taksa vjetore përmes rregullores nga Kuvendi i Komunës, si organ vendimmarrës për ushtrim të veprimtarisë dhe me këtë rast komunat çdo vit miratojnë rregullore për taksa dhe tarifa administrative për subjektet afariste dhe taksa të tjera të ndryshme sipas dispozitave ligjore.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigjen në padi duke theksuar se sa i përket vendimeve administrative të paditurës se nxjerrën në bazë të ligjit dhe rregulloreve komunale ndërsa pajtohet se e paditura në vend të shkresës përgjigje në ankesë është dashur të nxjerr vendim me të gjitha elementet e tij siç parasheh Ligji i Procedurës Administrative. Ka shtuar se e paditura ka shfuqizuar përgjigjen në ankesë të paditurës të datës 08.06.2017 pasi që ka pasur edhe raste tjera të ngjashme kur nga ana e gjykatës rekomanduar që brenda 30 ditëve të nxirret vendim sipas LPA-së. Duke pasur parasysh ligjshmërinë e vendimit të cekur nga i autorizuari i paditësi, deklaroj se i njëjti është nxjerr duke pasur parasysh edhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1359/15 të datës 24.05.2017, në një rast të ngjashëm dhe se neni 10 i Ligjit për Financa të Pushtetit Lokal i jep të drejt komunës që të përcaktoj taksa vjetore për subjektet afariste, ndërsa sa i përket Ligjit për Tregtinë e Brendshme për shfuqizimin e nenit 38 për leje të punës ajo dispozitë është shfuqizuar për leje të punës por e njëjta nuk i ndalon komunat që të nxjerrin rregullore e të cilat i përcaktojnë taksat.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit publik të datës 03.03.2020, ka administruar provat relevante dhe atë: Përgjigjen në ankesë e të Komunës së Hanit të Elezit-Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik 08-nr.4093-2017 të datës 08.06.2017, Ankesën e paditësit të dorëzuar tek e paditura të datës 01.06.2017, Aktvendimin me nr.08-nr.2653/94-2017 të datës 23.05.2017 të Komunës së Hanit të Elezit-Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, vendimin e të paditurës 08-nr.4093-2017 të datës 19.03.2018, Përgjigjen e Ministrisë së Financave të datës 27.08.2012, shkresën-konfirmimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të datës 23.04.2015, shkresën-konfirmimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të datës 20.04.2015.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 38 të LKA-së, në seancën shqyrtimit kryesor të datës 03.03.2020, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar për këto arsye:

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditura Komuna e Hanit të Elezit me shkresën-përgjigjen në ankesë 08-nr.4093-2017 të datës 08.06.2017 e ka njoftuar paditësin për refuzimin e ankesës dhe mbetjen në fuqi të aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës së Hanit të Elezit 08-nr.2653/94-2017 të datës 23.05.2017, me të cilin vendim paditësi ishte ngarkuar me pagesën e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, për vitin 2017 në shumë prej 280.00€. Më vonë e paditura Komuna e Hanit të Elezit-Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me vendimin me 08-nr.4093-2017 të datës 19.03.2018 ka refuzuar ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, për caktimin e taksës vjetore komunale dhe ka shfuqizuar përgjigjen në ankesë me nr.4093-2017 të datës 08.06.2017.

Gjykata konstaton se në këtë konflikt administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestuese fakti se aktit administrativ të paditurës të titulluar përgjigje në ankesë 08-nr.4093-2017 i datës 08.06.2017 dhe i nxjerr nga e paditura si përgjigje ndaj ankesës së paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës së Hanit të Elezit 08-nr.2653/94-2017 të datës 23.05.2017, me të cilin vendim paditësi ishte ngarkuar me pagesën e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2017, në shumë prej 280.00, i mungojnë elementet e përcaktuar me ligj, respektivisht i mungon forma, përmbajtja e aktit administrativ si dhe arsyetimi, të përcaktuar me nenet 84, 85 dhe 86 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, por kontestues ishte ligjshmëria e aktit administrativ të mëvonshëm të nxjerr nga e paditura atij me nr.08/nr.40493-2017 i datës 19.03.2018.

Përkundër faktit që e paditura me vendimin nr.08/nr.40493-2017 të datës 19.03.2018, ka refuzuar ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik të Hanit të Elezit dhe ka shfuqizuar përgjigjen në ankesë me nr.4093-2018 të datës 08.06.2017, gjykata konstaton se edhe ky vendim i të paditurës, me të cilin përfaqësuesi i autorizuar i paditësit u njoftua në seancë gjyqësore dhe të cilin e kontestoj dhe kërkoj anulimin e tij, është juridikisht i pa qartë, i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vet vetën dhe arsyetimin e tij. Në pikën e parë të dispozitivit të këtij vendimi thuhet refuzohet ankesa e subjektit afarist "B..." SHPK e parashtruar pranë Komunës së Hanit të Elezit, përkatësisht Komisionit për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, kundër Aktvendimit të Drejtorisë të Zhvillimit Ekonomik për caktimin e taksës vjetore komunale, mirëpo nga ky dispozitiv është e pa qartë se cila ankesë e paditësit është refuzuar konkretisht, ndaj cilit vendim është ushtruar ankesa, për cilin taksë vjetore, siç është e pa qartë se cili vendim i të paditurës është konfirmuar me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit. Për më tepër, gjykata konstaton se në pikën dy të dispozitivit të këtij thuhet se me këtë vendim shfuqizohet përgjigja në ankesë me nr.4093-2017 i datës 08.06.2017, mirëpo një gjë e tillë për gjykatën është e pa qëndrueshme, sepse nga ana e të paditës në radhë të parë, në dispozitivin e parë të vendimit do të duhej të ishte bërë shfuqizimi i aktit administrativ-përgjigjes në ankesë 08-nr.4093-2017 të datës 08.06.2017 sipas dispozitave ligjore të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, ndërsa tek më pastaj do të mund të vendosej lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës së Hanit të Elezit 08-nr.2653/94-2017 të datës 23.05.2017, me të cilin vendim paditësi ishte ngarkuar me pagesën e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2017.

Gjithashtu gjykata konstaton se vendimi i kontestuar i të paditurës nr.08/nr.40493-2017 i datës 19.03.2018, nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike administrative. Vendimi nuk përmban një përmbledhje të konstatimeve bazike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore ku bazohet akti, sikurse këshilla juridike e dhënë në vendim nuk është në përputhje me ligjin e aplikueshëm sepse bazuar në Ligjin nr.04/L-100 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.03/L-204, i cili ka hyrë në fuqi me 16 qershor 2012, neni 4, paditësi ka pasur të drejtë ankesë brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit nga Bordi Komunal i Ankesave, nga 01 dhejtori 2012 në Divizionin Fiskal të Departamentit për Çështje Adminsirtative-Divizioni Fiskal i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në pajtim me nenin 81B të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-së. Në bazë të këtij parimi, gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritorë në këtë konflikt administrativ për arsye se të metat e mësipërme janë të atij karakteri që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kontestuar.

Prandaj, gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë t'i shqyrtoj edhe njëherë pretendimet e paditësit të paraqitura në ankesën e datës 01.06.2017 të dorëzuar tek e paditura, lidhur me ngarkesën/taksen vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2017. E paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit të aktit administrativ të ri, duhet që të njëjtin ta nxjerr dhe ta mbështesë në dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili tani është i aplikueshëm dhe gjendjen faktike të konstatuar gjatë procedimit administrativ, duke u bazuar në provat materiale të siguruara sipas ligjit. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për të paditurën, bazuar në nenin 65 të LKA-së.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga çka u tha më lartë, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 43 par.2 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal**  
**A.nr.1011/17, datë 03.03.2020**

**Zyrtarja Ligjore**  
Asliha Fejzullahu

**Gj y q t a r i**  
Rexhep Gashi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.